



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA LIBRAZHD  
KRYETARI

Nr. 1593 Prot.

Librazhd më, 18 / 03 / 2021

VENDIM

Nr. exho, date 18 / 03 / 2021

PËR  
"PËRCAKTIMIN E VENDEVE PUBLIKE NË TERRITORTIN E BASHKISË  
LIBRAZHD PËR AFISHIMIT E MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE TË  
SUBJEKTEVE ZGJEDHORE"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", nenit 79 të ligjit nr.10119 datë 29/12/2008 "Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 3 i udhëzimit nr.6 datë 23/03/2021 "Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore";

VENDOSA;

1. Subjektet zgjedhore të afishojnë materialet e tyre propagandistike në një largësi prej 5m nga zyrat e tyre elektorale.
2. Ndalohet afishimi i materialeve në fasadat e godinave të banimit, institucioneve publike apo ambjenteve rrethuese pranë tyre, brenda zonave rekreative, parqeve, në pemët e qytetit dhe shtyllat e ndricimit.
3. Një kopje e këtij vendimi ju komunikohet subjekteve zgjedhore.
4. Me marrjen dijeni të këtij vendimi, subjektet zgjedhore brenda 5 ditëve kane detyrimin të japin informacion për adresat e sakta të zyrave elektorale dhe të bëhet verifikimi i tyre.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Policia Bashkiake.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Librazhd.

